

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Ndërmjet Byrosë Nacionale të Maqedonisë (NIB) dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) si entitete të autorizuara përgjegjëse për çështjet e sigurimit nga autopërgjegjësia në Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës në Njohjen Reciproke të Sigurimit nga Autopërgjegjësia për Palët e Treta (TPL) dhe procedurat e procesimit dhe trajtimit të dëmeve.

Duke pasur parasysh që:

NIB dhe BKS ("Palët") dëshirojnë të formojnë kornizën për:

- a) marrëveshjet për njohjen reciproke të policave valide të sigurimit të autopërgjegjësive nga palët e treta TPL dhe/ose Kartonit të Gjellbër ndërkombëtar valid, si vërtetim për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive në palës së tretë TPL, dhe
- b) marrëveshjet mbi trajtimin dhe pagesës së dëmeve si pasojë e aksidenteve të shkaktuara nga automjetet e siguruar në R. e Kosovës dhe R. Maqedonisë.

Palët janë pajtuar si në vijim:

I. DEFINICIONET

Për qëllimet e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MOU):

"BKS" nënkupton Byrosë Kosovare të Sigurimit

"NIB" nënkupton Byroja Nacionale e Maqedonisë

"Fondi Garantues" është fondi i themeluar ligjrisht, dhe i administruar nga BKS në Kosovë, respektivisht nga NIB në Maqedoni.

"Byroja për trajtime" është pala, qoftë ajo NIB, BKS apo anëtarët e saj të autorizuar-kompani e sigurimeve ose ndonjë entitet tjetër ligjor, cila trajton dhe kompenzon dëmet sipas dispozitave të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit dhe e cila kërkon kompenzim nga Anëtari Sigurues apo nëpërmes të Byrosë së Pagesave, në bazë të kushteve të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

"Anëtari sigurues" nënkupton kompaninë e licencuar të sigurimit, e cila është anëtare e NIB-së ose BKS-së, dhe të cilat kanë siguruar automjetin i cili ka shkaktuar aksidentin në fjalë, me anë të polisës së sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive apo Kartonit të Gjellbër.



“Byroja e pagesave” është byroja, qoftë NIB apo BKS, që është përgjegjëse për rimbursimin e dëmeve, të paguara nga Byroja për Trajtim, në pajtim me procedurat e këtij Memorandumi, që mëpastaj do t'i kompenzohet nga Anëtari sigurues.

“Vërtetimi mbi sigurimin” do të thotë ekzistenca e Çertifikatës valide TPL Plus të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive, për automjetet e regjistruara në Kosovë, të lëshuar nga Anëtari Sigurues në Kosovë, në rast të aksidenteve që ndodhin në Maqedoni, ose Kartonin e Gjelbër valid të NIB, për automjetet e regjistruara në Maqedoni, të lëshuar nga Anëtari Sigurues në Maqedoni, për aksidentet që ndodhin në Kosovë.

“Rregullorja e Brendshme” është Rregullorja e Brendshme e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Byrove, në Kretë më 30 Maj 2002, e reviduar me vendimet e posaçme të inkooporuara në Memorandumin Sgarues.

“Korrespondent” – nënkupton çdo kompani të sigurimeve – anëtare e NIB ose BKS ose çdo kompani e autorizuar për vlerësimin e dëmeve, e emëruar nga Byroja Paguese sipas kërkesës nga një apo më shumë anëtarë – kompani të sigurimeve me konfirmimin e palës siguruese ose një kompanie të themeluar dhe autorizuar për trajtimin dhe pagesën e dëmeve nga TPL. Definicionet, emërimet, autorizimet dhe trajtimi i dëmeve nga korrespondentët do të jetë në pajtim me standardet e themeluara sipas Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove në Bruksel.

II. NJOHJA RECIPROKE E PËRGJEGJËSISË SIGURUESE TË MJETEVE MOTORIKE

1. Shfrytëzuesit e automjeteve motorike të regjistruara në R. e Kosovës, të cilat posedojnë polisën valide të sigurimit TPL Plus të Kosovës, mund të hyjnë lirisht dhe të udhetojnë në Maqedoni. Kopja e mostrës së polisës TPL valide të sigurimit Plus të Kosovës i është bashkangjitur këtij Memorandumi si Shtojca I.

2. Shfrytëzuesit e automjeteve motorike të regjistruara në Maqedoni, të cilat posedojnë Kartonin e Gjelbër ndërkombëtar valid të lëshuar nga autoriteti i NIB, mund të hyjnë lirisht dhe të udhetojnë nëpër Kosovë. Kopja e mostrës së Kartonit të Gjelbër ndërkombëtar të Maqedonisë, i është bashkangjitur këtij Memorandumi si Shtojca II.

3. Secila palë duhet t'ia jap palës tjetër, listën ku përfshihen emrat e të gjithë Anëtarëve Sigurues, në ditën e nënshkrimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, dhe për çfardo ndryshimi duhet të njoftoj palën tjetër brenda 15 ditëve nga vënia në dijeni për këtë ndryshim.



4. Palët pajtohen që secili Karton i Gjelbër për të cilin supozohet se është lëshuar nga autoriteti i NIB, për automjetet e regjistruara në R. e Maqedonisë dhe për të cilin supozohet se është kompletuar si duhet për përdorim në Kosovë, apo secila Çertifikatë e polisës TPL Plus të Kosovës, për të cilën besohet se është lëshuar në Kosovë, për automjetet e regjistruara në Kosovë dhe e cila është e kompletuar si duhet për përdorim në R. e Maqedonisë, do të konsiderohet si dëshmi valide e sigurimit, në pajtim me Rregulloren e Brendshme (Marrëveshja e Kretës).

5. palët kontraktuese pajtohen që çdo certificate e sigurimit e cila supozohet të jetë lëshuar nga njëri nga anëtarët e Byrosë, sipas autorizimit të tyre, do të konsiderohet prove valide e sigurimit, edhe nëse është e falsifikuar, e paautorizuar ose e ndryshuar në mënyrë ilegale – në pajtim me nenin 9 të Rregullores së Brendshme.

III. TRAJTIMI DHE PAGESA E KËRKESAVE PËR ZHDËMTIM

1. Secila palë do të trajtoj dhe të paguaj kërkesat për zhdëmtim që i janë adresuar nga pala tjetër apo drejtëpërdrejt nga paraqitësi i kërkesës për zhdëmtim, brenda autorizimeve të MOU, në pajtim me Nenin IV të kësaj MOU, dhe në baza të njëjta siç trajton dhe paguan kërkesat për zhdëmtim të paraqitura nga personat e siguruar brenda jurisdiksonit përkatës të tyre.

2. Me këtë Memorandum të Mirëkuptimit, përfshihet raportimi, trajtimi dhe pagesa e kërkesave për zhdëmtim në rast të lëndimeve personale si dhe për humbje apo dëmtim të pasurisë:

(a) që kanë ndodhur si pasojë e ndonjë aksidenti në R. e Maqedonisë, të shkaktuar nga automjetet e regjistruara dhe të siguruar në Kosovë, të cilat posedojnë polisën e sigurimit të detyruar të autopërgjegjësive TPL, si dëshmi e ekzistimit të sigurimit, ose

(b) që kanë ndodhur si pasojë e ndonjë aksidenti në Kosovë, të shkaktuar nga automjetet e regjistruara dhe të siguruar në R. e Maqedonisë, të cilat posedojnë Kartonin e Gjelbër valid të NIB.

3. Në rast të aksidentit, Byroja për Trajtime, është e obliguar që menjëherë të njoftoj Byronë për Pagesa, për çfardo kërkesë për zhdëmtim, dhe duhet të veproj në interesin e Byrosë për Pagesa sikur vetë të kishte lëshuar Dëshminë e sigurimit.

4. Pasi që të paguhet kompensimi, Byroja Trajtuese, është e obliguar t'i dërgoj Byrosë për Pagesa, të gjitha dokumentet e nevojshme për të justifikuar pagesën, duke përfshirë edhe raportin e policisë, i cili përmbanë të dhënat mbi pjesëmarrësit në aksidentin e tillë, fotografitë e automjetit të dëmtuar, ekspertizën profesionale në vlerësimin e dëmit, si dhe Çertifikatën e Sigurimit apo, kur kjo nuk është e mundur, numrin e polisës së

